



Pranuar / Dorezuar Priljen / Prodato Received / Delivery	16.09.2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jednica Org / Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtesa Prilog Appendix	Sasia Kolicitna Quantity
SPMBHCK	5434/2022		114



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.634/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani-anëtarë, më Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, bazuar në Aktgjykimin A.nr.2344/2021 të datës 27.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.634/2021 të datës 12.07.2021 të parashtruar nga ankuesi nga fshati

Komunën e Obiliqit, kundër organit të punësimit Komunës së Obiliqit, në çështjen juridike "kompensim material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 16.09.2022, mori këtë:

V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.634/2021 e datës 12.07.2021 e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi tani i pensionuar, më datë 12.07.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3618/2021 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin së bazuar në Kontratën Kolektive të njëjtit me rastin e pensionimit i njihet e drejta e pagesës në shpërblim jubilar dhe dy paga mujore në lartësi prej tri pagave në tre muajt e fundit.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 15.07.2021 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Komuna e Obiliqit, ndërsa kjo e fundit më datë 23.07.2021 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedure.

Këshilli në mungesë të kuorunit për vendosje përmes shkresës me numër protokoll 4410 të datës 26.08.2021 ka njoftuar ankuesin lidhur me arsyet e mos shqyrtimit të ankesës, duke udhëzuar të njëjtin lidhur me të drejtën e inicimit të konfliktit administrativ në gjykatën kompetente.

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative me Aktgjykimin A.nr.2344/2021 të datës 27.07.2022, ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësit, tani ankuesit, dhe ka detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh të vendos lidhur me ankesën e ankuesit A.nr. 634/2021.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokoll 3618/2021 të datë 12.07.2021 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e Këshillit me numër protokoll 4410 të datës 26.08.2021; Njoftimin XII-26 të datës 14.06.2021 nga Udhëheqësi i Personelit për ankuesin; Përgjigjen në kërkesë Nr.XII-27 të datës 21.06.2021 nga Udhëheqësi i Personelit për ankuesin; Kërkesën e datës 16.06.2021 dhe 10.06.2021 nga ankuesi; Formularin për kërkesë apo ankesë i datës 16.06.2021 dhe 10.06.2021; Përgjigjen në ankesë XII-147 të datës 23.07.2021, Akt Emërimit Nr.II/03 të datës 03.01.2013 të ankuesit; Vendimin me Nr. II-376 i datës 29.04.2021 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Vendimin Nr.II-377 të datës 29.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Vendimin Nr.II-1250 i datës 27.10.2020 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Vendimin Nr.II-1338 të datës 27.10.2020 i Kryetarit të Komunës së Obiliqit; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 15.07.2021; emailin e datës 29.07.2021 nga _____ për KPMSHCK-në, Listën e pagave e muajit maj 2021 për ankuesin; Urdhër Obligimi për Pagesë i datës 07.12.2020; Aktgjykimin A.nr.2344/2021 të datës 27.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit të aktgjykimit A.nr.2344/2021 të datës 27.07.2022 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, si dhe pas administrimit të të gjitha provave të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi së janë të pabazuar pretendimet ankimore të ankuesit, SEPSE:

Nga shqyrtimi i shkresave të lëndës Kolegji ka gjetur së ankuesi ka qenë i punësuar në Komunën e Obiliqit, në pozitën e punës "*Zyrtar i Shërbimeve Sociale*", në Qendrën për Punës Sociale, dhe si i njëjti sipas Vendimit me numër protokoll II-376 të datës 29.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, është pensionuar për shkak të arritjes së moshës së pensionimit, ndërsa me Vendimin me numër protokoll II-377 të datës 29.04.2021 të Kryetarit të Komunës së Obiliqit, ankuesit i është njohur e drejta e kompensimit të një pagese në vlerën 393.32 Euro.

Ankuesi më datë 10.06.2021 ka parashtruar kërkesë pranë Njesisë së Burimeve Njerëzore të Komunës së Obiliqit, për kompensimin e shpërblimit jubilar dhe dy pagave mujore në lartasi prej tri pagave të tre muajve të fundit, kurse Udhëheqësja e Personelit e Komunës së Obiliqit në përgjigje të kërkesës së ankuesit, më datë 14.06.2021 ka njoftuar të njëjtit së bazuar në Ligjin Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe Rregulloren Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë, ankuesit i ka takuar e drejta vetëm në kompensim të një pagesë në vlerën e pagës së fundit.

Ankuesi më kërkesë të njëjtë, më datë 16.06.2021 i është drejtuar Komisionit të Ankesave të Komunës së Obiliqit, ndërsa Udhëheqësja e Personelit të Komunës së Obiliqit ka njoftuar ankuesin së për kërkesën në fjalë, ka marr përgjigje me datë 14.06.2021.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në ankesën në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, pretendon së bazuar në Kontratën Kolektive të njëjtit me rastin e pensionimit i njihet e drejta e pagesës në shpërblim jubilar dhe dy paga mujore në lartësi prej tri pagave në tre muajt e fundit.

Kolegji i Këshillit ka shqyrtuar bazën ligjore mbi të cilën janë ngritur pretendimet ankimore të ankuesit dhe si rrjedhojë ka konstatuar se Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës (MPKK) e publikuar në Gazetën Zyrtare Nr.38/2014 të datës 18.06.2014, ka hyrë në fuqi me datë 01.01.2015 dhe se e njëjta sipas nenit 90 paragrafi 4 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, ka qenë e zbatueshme në periudhën jo më shumë se tri (3) vjet, respektivisht deri me datë 31.12.2017. Kolegji po ashtu ka konstatuar se Oda Ekonomike e Kosovës si Partner i barabartë në Këshillin Ekonomiko Social, dhe njëherit nënshkruese e MPKK-së, me datë 15.09.2017 është tërhequr nga zbatimi i MPKK-së, dhe rrjedhimisht ka pamundësuar zbatimin e Marrëveshjes së Përgjithshme Kolektive, pas datës 31.12.2017. Andaj, mbi këtë bazë rezulton së janë të pa bazuara pretendimet ankimore të ankuesit, sepse ankuesi ka arritur moshën e pensionimit me datë 18.05.2021 respektivisht në kohën kur nuk është e aplikueshme Marrëveshja e Përgjithshme Kolektive e Kosovës.

Nga vlerësimi i provave të lëndës, Kolegji ka konstatuar së organi i punësimit ka bërë kompensimin e një page mujore të njëhershme (pagës përcjellëse) me rastin e pensionimit të ankuesit në vlerën e pagesë së fundit, gjegjësisht në vlerë prej 356.96 Euro, rrjedhimisht nisur nga ky konstatim, rezulton se Komuna e Obiliqit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafit 2 nën paragrafit 2.2 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe dispozitat e nenit 19 paragrafit 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë i cili përcakton që: 1. *Sipas nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit në Shërbimin Civil, gëzon të drejtën e kompensimit.* 2. *Nëpunësi civil, që arrin moshën e pensionimit, gëzon të drejtën e marrjes së një pagese në shumën e një (1) page mujore të njëhershme në vlerën e pagesë së fundit”,* kështu që pretendimi ankimor i ankuesit për kompensimin e dy pagave përcjellëse me rastin e pensionimit është i pa bazuar.

Përkitazi me pretendimin e ankuesit për kompensimin e shpërblimit jubilar, Kolegji në bazë të dëshmive të lëndës gjegjësisht sipas Urdhër Obligimit për Pagesë të datës 07.12.2020 ka konstatuar së ankuesit i është bërë kompensimi për 20 vite përvojë punë në shërbimin civil në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil, respektivisht në shumë prej 180.68 Euro, kështu që nisur nga ky konstatim rrjedhë së organi i punësimit ka vepruar në pajtim me nenin 22 paragrafi 2 nën paragrafi 2.3 të Ligjit Nr. 03/L-147 për Pagat e Nëpunësve Civilë dhe nenin 21 të Rregullores Nr. 33/2012 për Shtesat në Pagë dhe Kompensime të tjera të Nëpunësve Civilë ku përcaktohet se : *“Sipas Nenit 22 të Ligjit për Pagat e Nëpunësve Civilë, nëpunësve civilë, të cilët janë në marrëdhënie të vazhdueshme pune në Shërbimin Civil iu takon një shpërblim në vlerë prej 25% të pagës mesatare në Shërbimin Civil pas çdo dhjetë*



(10) vjetësh pune", rrjedhimisht Kolegji vlerëson së pretendimi i ankuesit për kompensim të shpërblimit jubilar është i pabazuar.

Siç u tha me sipër, pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, si dhe neni 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.634/2021

Avdyl BEKTESHI

[Signature]
Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

[Signature]
Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Obiliqit;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Obiliqit; dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.

